UDHËZIM
Nr.3922, datë 28.4.2010

PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË DËNIMEVE TË DHËNA NDAJ SHTETASVE SHQIPTARË NGA AUTORITETET GJYQËSORE TË HUAJA

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, dhe të nenit 76, paragrafi 1 të ligjit nr.10193, datë 3.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale",

UDHËZOJ:

1.Zyra e Gjendjes Gjyqësore krijon një regjistër të posaçëm për regjistrimin e vendimeve penale të autoriteteve gjyqësore të huaja, të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë. Regjistri i posaçëm përfshin regjistrin shkresor dhe regjistrin elektronik, të cilët krijohen sipas modelit të regjistrit shkresor të gjendjes gjyqësore dhe regjistrit elektronik të gjendjes gjyqësore të administruar nga kjo zyrë, në përputhje me ligjin nr.9614, datë 21.9.2006 "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore".

2.Regjistri i posaçëm përmban gjeneralitetet e të dënuarit, ku shënohet vendqëndrimi i të dënuarit, si dhe shtetësia e dytë nëse ai ka, një kolonë të veçantë mbi shtetin dënues, një kolonë për vendimet që janë njohur nga gjykatat shqiptare dhe një kolonë për përputhshmërinë e dënimit me legjislacionin shqiptar. Në këtë kolonë të fundit shënohet dispozita penale që i korrespondon veprës penale sipas legjislacionit shqiptar ose shënohet "nuk parashikohet nga ligji penal shqiptar". Forma dhe përmbajtja e regjistrit të posaçëm është sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

3.Zyra e Gjendjes Gjyqësore regjistron shkurtimet e vendimeve të autoriteteve gjyqësore të huaja, të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë. Këtu përfshihen edhe vendimet e dhëna ndaj shtetasve shqiptarë të lindur jashtë vendit.

4.Shkurtimet e vendimeve në regjistrin e posaçëm regjistrohen:

a) në regjistrin shkresor;

b) në regjistrin elektronik.

5. Drejtoria e Marrëdhënieve juridiksionale me jashtë në Ministrinë e Drejtësisë i përcjell vendimet gjyqësore në zyrën e gjendjes gjyqësore brenda pesë ditëve nga marrja e vendimeve gjyqësore nga autoritetet e huaja gjyqësore. Zyra e gjendjes gjyqësore përditëson menjëherë regjistrin shkresor dhe elektronik çdo herë që Ministra e Drejtësisë dërgon informacion mbi vendime të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë.

6. Përpunimi i të dhënave në regjistrin elektronik bëhet vetëm nga personi i autorizuar nga titullari i zyrës së gjendjes civile.

7. Zyra e gjendjes gjyqësore mban dhe përpunon të dhënat mbi vendimet e autoriteteve gjyqësore të huaja që jepen ndaj shtetasve shqiptarë, në përputhje me ligjin nr.9614, datë 21.9.2006 "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore" dhe ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

8. Të drejtën e aksesit në regjistrin elektronik të vendimeve gjyqësore që mbahet sipas këtij udhëzimi e kanë:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;

b) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

c) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;

ç) Interpoli;

d) Ministria e Brendshme;

dh) Ministria e Drejtësisë;

e) Ministria e Mbrojtjes;

ë) Prokuroria e Pëergjithshme;

f) Shërbimi Informativ i Shtetit;

g) Shërbimi Informativ Ushtarak.

9. Ministri i Drejtësisë pranon kërkesat për akses në regjistrin elektronik, të institucioneve të tjera publike, veprimtaria e të cilave ka të nevojshme njohjen me informacionin mbi vendimet penale që jepen nga autoritetet gjyqësore të huaja ndaj shtetasve shqiptarë.

10. Drejtuesit e institucioneve të parashikuara në pikën 9 të këtij udhëzimi, paraqesin kërkesën për akses pranë Ministrit të Drejtësisë. Institucioni kërkues duhet të motivojë nevojën për të pasur akses tek ky informacion duke përcaktuar dhe emrin e personit që do të ketë akses.

11. Institucionet e tjera të cilat nuk kanë të drejtë aksesi në regjistrin elektronik, mund të kërkojnë nga zyra e gjendjes gjyqësore informacion në lidhje me dënime të dhëna nga autoritetet gjyqësore të huaja ndaj shtetasve shqiptarë, duke argumentuar nevojën për informacionin specifik.

12. Institucionet e autorizuara për të patur akses në regjistrin elektronik të vendimeve të autoriteteve gjyqësore të huaja të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë dhe ato të parashikuara nga në pikën 9 të këtij udhëzimi, e përdorin informacionin vetëm për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tyre dhe janë të detyruar të respektojnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

13. Ngarkohet zyra e gjendjes gjyqësore për zbatimin e këtj udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani

REGJISTRI I DËNIMEVE Aneksi 1

Nr.Prot	Data e regjistrimit	Mbiemër, emër,Alias	Atësia	Amësia	Datëlindja	Vendlindja	Vendqëndrimi	Shtetësia e dytë	Shteti dënues

TË DHËNA NDAJ SHTETASVE SHQIPTARË NGA AUTORITETET GJYQËSORE TË HUAJA

Autoriteti gjyqësor	Nr.i vendimit	Data e vendimit	Dispozitivi i vendimit	Njohja nga gjykata shqiptare	Gjykata që e ka njohur

Nr. i vendimit	Data e vendimit	Përputhja e veprës me legjislacionin shqiptar